



SHKOLLA NEHEMIA

# LETËR INFORMUESE

Letër informuese për prindërit

Botimi Nr. 4: Mars - Qershor 2019

Të rinjve dhe adoleshentëve u pëlqejnë sfidat dhe kapërcimi i tyre me sukses ndikon në rritjen e tyre në mënyrë të shëndetshme. E ku më mirë se në një kamp fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë mund të sfidohen dhe ndihmohen për të rritur vetëbesimin e tyre? Kjo është dhe arsyeja pse Royal Rangers Albania ka organizuar kampe të ndryshme, me fëmijët të grupmohave të ndryshme dhe në vende të ndryshme

Gjatë muajit maj, Nehemiah Gateway University u ofroi nxënësve tanë orë këshillimi për karrierën.

Si çdo vit, ne patëm kënaqësinë të mirëprisnim mësueset praktikante nga Ludwig-Maximilians-University Mynih, të cilat praktikuan aftësitë e tyre mësimore në Shkollën NEHEMIA, duke u dhënë një mundësi nxënësve të mësonin gjermanisht nga gjermano-folës.

Nxënësit e dalluar kanë marrë fletët e lavdërimit, në një aktivitet ku morën pjesë edhe prindërit e tyre.

Arsimi fillor ka zhvilluar aktivitete të shumta në javët e fundit të shkollës, si dramatizime, kërcime, aktivitete sportive dhe projekte të ndryshme.

Për t'u ardhur në ndihmë nxënësve të klasave të 10-ta në përzgjedhjen e profesionit të tyre të ardhshëm, Nehemiah Gateway Albania u ka ofruar atyre mundësi praktike në projekte të tilla si: marketing, financë, punë sociale etj. Tetë nxënës të interesuar janë duke zhvilluar këtë praktikë nga data 20.06 - 20.07.2019.



Rr. Nehemia  
7304 Buçimas  
Albania

T: +355 83 600 403  
www.nehemiah-gateway.al



## Të dashur prindër,

ditët i lenë radhën njëra-ijetrës dhe ndodhemi tashmë në fund të qershorit.

Viti shkollor ka mbaruar dhe nxënësit kanë filluar tashmë pushimet e tyre.

Në fillim të vitit shkollor 2018-2019, ne ju prezantuar me Programin e Zhvillimit të Shkollës dhe në kuadër të këtij programi, midis të tjerash, organizuam eventin "Hapësirë e lirë" në fillim të shkurtit 2019.

Pasi mblodhëm mendimet dhe sugjerimet tuaja, grupi i punës është marrë me kategorizimin dhe përpunimin e tyre si edhe të rezultateve të pyetësorëve të ndryshëm me ju si prindër, me mësuesit dhe nxënësit.

Është hartuar plani zhvillimor i shkollës dhe janë vendosur objektivat afatgjatë, afatmesme dhe ato afatshkurtra. Në këtë letër informuese, duam t'ju informojmë për këtë plan si edhe t'ju japim një pasqyrë të aktiviteteve të shkollës për muajt mars-qershor.

Shfrytëzojmë rastin të kërkojmë përsëri bashkëpunimin tuaj të ngushtë për realizimin e objektivave për vitin

shkollor 2019-2020.

Ju urojmë pushime të mbara dhe presim me kënaqësi të shihemi përsëri në shtator 2019.

Ndërhuni të lirë të na kontaktoni në adresat e e-mailit të paraqitura më poshtë.

Me respekt dhe për të ardhmen e fëmijëve tanë,

Drejtorja e Shkollës NEHEMIA

Elona Rira  
elona.rira@nehemiah-gateway.org

Donika Nasto  
donika.nasto@ng.team



## Shkolla NEHEMIA në të ardhmen

Shkolla NEHEMIA u krijua në vitin 1998 në Pogradec me vizionin për të krijuar një ndryshim të qëndrueshëm në shoqërinë shqiptare. Ndryshe nga projektet sociale, me të cilat Fondacioni Nehemia (tani Nehemiah Gateway Albania) vepron në atë kohë, Shkolla NEHEMIA ishte një nga projektet e para që nuk kishte si synim nevojat akute të të rinjve, por mbështetjen dhe pajisjen e tyre afatgjatë me aftësi për të përballuar vetë të ardhmen dhe për të ndikuar pozitivisht në shoqëri.

Pas njëzet viteve, shkolla ka arritur disa suksese dhe ka nxjerrë nxënës të kualifikuar të cilët tani janë duke studiuar më tej dhe/ose kanë filluar karrierën e tyre profesionale kudo nëpër botë. Renditja e shkollave dhe testet e jashtme tregojnë një nivel të mirë të marrjes së njohurive nga nxënësit dhe ka një kërkesë të madhe nga ana e prindërve për t'i sjellë fëmijët e tyre në Shkollën NEHEMIA.

Sidoqoftë, shkolla ka potenciale përmirësimi dhe qëllimi i Programit për Zhvillimin e Mëtejshëm të Shkollës është pikërisht adresimi i këtyre çështjeve dhe përparimi i mëtejshëm i saj.

“Në qoftë se nuk e di qëllimin që do të arrish, asnjë rrugë nuk të çon atje”: - thotë një fjalë e urtë.

Ne, si Shkollë NEHEMIA, kemi vazhdimisht parasysh misionin e Nehemiah Gateway:

“Të ndihmojmë dhe fuqizojmë njerëzit që në mënyrë të qëndrueshme të formojnë dhe përcaktojnë jetët e tyre me dinjitet dhe pavarësi.”

Ajo çka nënkuptohet me këtë deklaratën e misionit për

Shkollën NEHEMIA: Shkolla NEHEMIA synon të mbështesë dhe fuqizojë nxënësit përmes edukimit, duke patur si qëllim t’i trajnojë ata për jetën dhe komunitetet e tyre.

Sigurisht që përmbushja e këtij misioni është një sipërmarrje shumë e madhe në përmasa dhe në kohë dhe nuk do të na mjaftonte vendi në këtë letër informuese për të zbërthyer sa kemi arritur dhe sa na ka mbetur akoma për të arritur përmbushjen e tij.

Qëllimi i Shkollës NEHEMIA është edukimi i gjithanshëm i nxënësit, në mënyrë që mbas mbarimit të shkollës ai:

- të ketë zhvilluar konceptin për veten;
- të ketë mësuar si të kapërcejë problemet dhe sfidat
- të ketë mësuar si të hartojë objektiva dhe t’i përmbushë ato
- të ketë mësuar të marrë përgjegjësi
- të ketë mësuar si të mësojë me të tjerët dhe nga të tjerët
- të ketë mësuar të mësoarin
- të marrë me vete vlerat dhe parimet e Shkollës NEHEMIA

Në vazhdimësi të ecurisë së Shkollës NEHEMIA, duam të fokusohemi në zhvillimin e këtyre fushave të cilësisë:

1. Menaxhimi dhe qeverisja e shkollës
2. Kultura dhe mjedisi shkollor
3. Mësimdhënia dhe nxënia
4. Zhvillimi profesional i nxënësve



5. Performanca e nxënësve
6. Programi i zhvillimit të shkollës
7. Gjithpërfshirja
8. Infrastruktura dhe administrimi

Secila prej këtyre pikave është e ndarë përsëri në prioritetet dhe nën-prioritetet, ku ndër më kryesoret janë: përmirësimi i vazhdueshëm i komunikimit dhe organizimit, kualifikimi i mëtejshëm i stafit mësimor, fokusimi i mëtejshëm tek krijimi i një kulture shkolle në përputhje me vlerat e Nehemiah Gateway, rritja e nivelit akademik të nxënësve, të aftësive të tyre kroskurrikulare dhe sociale, rritja e interesimit të nxënësve dhe një bashkëpunim më i ngushtë me prindërit. Shkolla NEHEMIA do të fokusohet gjithashtu në rritjen e përqindjes së përdorimit të teknologjisë dhe metodave mësimore bashkëkohore.

Veprimtaritë ekstrakurrikulare që ofron shkolla do të jenë më të zgjeruara, më të organizuara dhe do të ketë një rritje të numrit të partneriteve të lidhura brenda dhe jashtë vendit.

Ne duam që të përforcojmë gjithashtu edhe bashkëpunimin me ju si prindër dhe me komunitetin përreth.

Ne presim që këshillat e klasave të mirëfunksionojnë, të takohen vazhdimisht dhe të jenë një mbështetje për klasën dhe shkollën. Përveç kësaj, shumë aktivitete ekstrakurrikulare nuk do të mund të zhvillohen me sukses nëse nuk do të kemi angazhimin tuaj vullnetar. Për këtë do të mbetemi në komunikim të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit shkollor.

Së bashku do t’ia dalim!



## Aktivitete të ndryshme

Një mundësi shumë e mirë për nxënësit, që ata të sfidohen dhe të matin veten e tyre janë olimpiadat.

Më 23 mars u zhvillua konkursi i matematikës “Kangaroo”. Ky konkurs ndërkombëtar zhvillohet në të njëjtën datë në të paktën 90 vende të botës. Qëllimi është t’u paraqitet nxënësve nga klasa e parë deri në të 12-të, një konkurs i bukur dhe tërheqës, që t’i frymëzojë ata për t’u zhvilluar në drejtimin e matematikës. Nga Shkolla NEHEMIA morën pjesë 47 nxënës të klasave I-XII, nga të cilët pesë ishin fitues.

**(për më shumë informacione rreth këtij konkursi: [www.kangaroo.al](http://www.kangaroo.al))**

Një projekt i veçantë, i nisur tashmë prej dy vitesh është edhe projekti “Përgjegjësia Sociale”. Ky projekt u mëson fëmijëve përgjegjësinë sociale duke u dhënë atyre një shans për t’u praktikuar! Nxënësit e klasës së 6-të dhe së 7-të kishin një vit shumë emocionues duke mësuar rreth rolit të tyre në komunitet, se si të jenë aktivë dhe përgjegjës për njerëzit e tjerë dhe për mjedisin e tyre. Në datën 24 maj, ata morën certifikatat e tyre të merituar!

Policia e shtetit, në bashkëpunim me Nehemiah Gateway Albania, më 27 maj organizoi një trajnim me temën "Sjellja shoqërore dhe masat mbrojtëse për një lëvizje më të sigurt në rrugë". Qëllimi ishte edukimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve për mënyrat e mbrojtjes, masat e sigurisë dhe sjelljen sociale ndaj fenomeneve të padëshiruara. Në këtë trajnim morën pjesë nxënësit e Shkollës NEHEMIA dhe Gjergj Pekmezi.